



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 387 / Prot.

Tiranë, më 15. 11.2024

V E N D I M

Nr. 217, datë 15 / 11 /2024

P Ë R

MIRATIMIN E “KODIT TË ETIKËS TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”

Në mbështetje të neneve 6, pika 3, 19, pika 1, 25, pika gj, 37, pika 2, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me propozim të grupit të punës të ngritur me Urdhrin nr. 28, datë 12.3.2024 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për ngritjen e grupit të punës për përditësimin e Kodit të Etikës të KLSH-së”,

V E N D O S A

1. Miratimin e “Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 56, datë 30.4.2015 “Për miratimin e Kodit Etik të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, shfuqizohet.
3. Vendimi nr. 27, datë 20.4.2018 “Për miratimin e ‘Kodi Etik i Kryetarit dhe drejtuesve të lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit’”, i ndryshuar me vendimin nr. 28, datë 23.4.2018 “Për një shtesë në ‘Kodi Etik i Kryetarit dhe drejtuesve të lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit’”, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, shfuqizohet.
4. Ngarkohen punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për njoftimin e këtij vendimi punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
6. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Arben SHEHU



Hyrje

Institucioni kushtetues i Kontrollit të Lartë të Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar që ushtron auditimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë. Nëpërmjet auditimeve, ai synon përdorimin me efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.

Në këtë mënyrë, si institucion i pavarur, auditues i jashtëm i financave publike, Kontrolli i Lartë i Shtetit kontribuon në mënyrë themelore për qeverisjen e mirë të fondeve publike në shërbim të taksapaguesve dhe qytetarëve. Për të realizuar këtë mision, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcjellë besueshmëri tek palët e interesit, duke vepruar si një institucion model dhe duke promovuar e ruajtur etikën dhe vlerat morale në çdo aspekt të aktiviteteve të tij. Ndaj, secili punonjës i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të kontribuojë në vendosjen dhe rritjen e besimit tek palët e interesit, subjektet e audituara dhe publiku, duke u sjellë në mënyrë etike dhe profesionale, dhe duke shmangur çdo situatë apo rrethanë që mund të dëmtojë imazhin e institucionit.

Për të garantuar besimin publik në integritetin e Kontrollit të Lartë të Shtetit hartohet ky Kod i Etikës, i cili përmban vlerat dhe parimet që duhet të ndiqen dhe të udhëheqin veprimtarinë e të gjithë punonjësve të institucionit, në të gjitha nivelet, si dhe të personave të tjerë që punojnë në emër të këtij institucioni, për të siguruar një sjellje dhe mjedis pune që nxisin zbatimin e parimeve të etikës sipas standardeve ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Këta subjekte, nga ana tjetër, kanë detyrimin që t'i njohin dhe t'i zbatojnë me korrektësi parashikimet e Kodit të Etikës gjatë përmbushjes së detyrave dhe në jetën e përditshme.

Kodi u mundëson punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit që të identifikojnë, vlerësojnë e shmangin reagime apo situata që mund të kërcënojnë respektimin e parimeve themelore të etikës dhe shërben si udhëzues praktik për diskutimet dhe qëndrimet që lidhen me mëdyshjet dhe paqartësitë etike, nën frymën e akteve ligjore e nënligjore dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit, që normojnë veprimtarinë e këtij institucioni e që trajtojnë çështjet e etikës.

Kodi Etik u hartua nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 28, datë 12.3.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përditësimin e Kodit Etik të KLSH-së”, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me kontributin e trupës drejtuese, duke pasur për bazë parashikimet e ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet ndërkombëtare të INTOSAI-P1 “Deklarata e Limës”, INTOSAI – P-10 “Deklarata e Meksikës: Mbi pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit”, INTOSAI-P12 “Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit”, ISSAI 130 “Kodi i Etikës”, dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KODI I ETIKËS I KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kodi i Etikës synon të drejtojë sjelljen e duhur të punonjësit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë ushtrimit të funksionit apo detyrës, gjatë kryerjes së veprimtarisë së jashtme dhe në jetën private të tij, në përputhje me standardet etike dhe interesin publik, të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 2 Objekti

1. Ky Kod përcakton standardet dhe rregullat e etikës, të qëndrimit dhe të sjelljes së punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe ato për trajtimin, strukturat përgjegjëse dhe zgjidhjen e çështjeve etike.

Neni 3 Fusha e veprimit

1. Standardet dhe rregullat etike të këtij Kodi janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, punonjësit administrativë që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nga ekspertët e përkohshëm të jashtëm, të kontraktuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 4 Rregulla të përgjithshme

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes etike dhe profesionale si dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që të mbrohen integriteti dhe pavarësia e tij si dhe të parandalohen shkeljet e ligjit. Dispozitat e këtij Kodi duhet të interpretohen dhe zbatohen për të arritur këtë objektiv.

2. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në fillim të marrëdhënieve të punës, plotëson një deklaratë ku shprehet se është njohur dhe merr përsipër zbatimin e dispozitave të këtij Kodi.

3. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të përditësojë rregullisht njohuritë për politikën dhe parimet themelore etike institucionale si dhe për rrethanat që mund të vënë në rrezik këto parime dhe masat mbrojtëse ndaj tyre. Rrethanat të tilla janë interesat vetjake të natyrës financiare ose jo financiare, auditimi i punës së mëparshme nga i njëjti person, favorizimi, familjariteti në marrëdhëniet apo me interesat e subjektit të audituar ose të palëve të treta, ose frika nga kërcënimet që mund të bëhen gjatë procesit auditues.

4. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të informojë eprorët dhe Strukturën e Etikës për çdo konflikt apo situatë që mund të cenojë apo rrezikojë kërkesat për një sjellje etike dhe profesionale të parashikuara në Kodin e Etikës.

5. Të gjithë subjektet ndaj të cilëve zbatohen rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës, duhet të marrin masa që të rregullojnë menjëherë marrëdhëniet dhe veprimtarinë e tyre në pajtim me rregullat e këtij Kodi.

6. Format specifike të sjelljes të parashikuara në këtë Kod nuk janë shteruese, pasi nuk ofrojnë një listë të plotë të të gjitha situatave me të cilat mund të përballet në praktikë dhe në jetën e përditshme punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

7. Për çështjet etike që nuk rregullohen në këtë Kod, punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe strukturat përgjegjëse duhet t'u referohen parimeve të përgjithshme të etikës, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe akteve nënligjore të brendshme.

KREU II PARIMET THEMELORE DHE RREGULLAT E SJELLJES ETIKE

Neni 5 **Parimet themelore**

1. Parimet mbi të cilat mbështeten standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së punonjësit të Kontrollit të Lartë të Shtetit janë:

- a) ndershmëria, integriteti dhe korrektësia;
- b) pavarësia dhe objektiviteti;
- c) ruajtja e konfidencialitetit të informacionit zyrtar;
- ç) njohuritë dhe aftësitë profesionale;
- d) sjellja profesionale.

Neni 6 **Ndershmëria, integriteti dhe korrektësia**

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit sillet gjithnjë në mënyrë të tillë që të ruajë dinjitetin, përgjegjësitë në kryerjen e detyrës si dhe paanshmërinë e pavarësinë e institucionit. Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësi duhet të jetë i lirë dhe i pandikuar nga çdo lidhje ose çdo interes, personal, politik, familjar dhe shoqëror, prireje ose paragjykim që ndikon në aftësinë e tij për të vepruar në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe të arsyeshme. Sipas këtij parimi, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit:

a) kujdeset që të veprojë me integritet të lartë moral e profesional si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën e tij private, me qëllim garantimin e besimit publik tek institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

b) vepron e sillet në mënyrë të tillë që të reflektojë ndershmëri, duke nxitur vlera dhe parime të larta etiko-morale, dhe inkurajon punonjësit e tjerë të Kontrollit të Lartë të Shtetit që të veprojnë në përputhje me këto vlera;

c) duhet të udhëhiqet nga mirësjellja dhe ndershmëria profesionale, korrektesa në marrëdhëniet e tij me eprorët, kolegët dhe vartësit, subjektet e audituar, median dhe publikun;

ç) shmang sjelljet që bien në kundërshtim me ligjin si dhe ato që tregojnë mungesë ndjeshmërie apo kujdesi;

d) shmang përfshirjen në veprimtari politike apo lobime të kësaj natyre;

dh) shmang interesa ose marrëdhënie personale, financiare ose të tjera, që bien ndesh me interesat e Kontrollit të Lartë të Shtetit;

e) shmang çdo mundësi për përdorimin e pushtetit apo detyrës që kryen, për përfitime personale;

ë) nuk lejon që marrëdhëniet familjare, shoqërore apo të tjera, të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në sjelljen apo kryerjen e detyrës prej tij;

f) shmang çdo përfitim personal, për vete, familjarë apo të tjerë, që vjen për shkak të detyrës;

g) nuk kërkon dhe as nuk pranon dhurata, hua, apo favore, për vete ose anëtarët e familjes së tij, që i vijnë për shkak të detyrës;

gj) tregon kujdesin e duhur lidhur me aksesin dhe përdorimin e burimeve të vlefshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Gjatë procesit auditues, përveç sa më lart, punonjësi që kryen funksione audituese:

a) tregon kujdesin e duhur për mbledhjen e të dhënave të besueshme për subjektin që do të auditohet;

b) kryen në kohë dhe me përgjegjësi detyrat, në zbatim të rregulloreve në fuqi dhe udhëzimeve të eprorëve;

c) kryen konsultime dhe tregon kujdes gjatë trajtimit të çështjeve të ndërlikuara apo me ndjeshmëri të lartë publike, bazuar në çdo rast mbi gjykimin profesional;

ç) paraqet në mënyrë të plotë dhe të sigurtë rezultatet e auditimit;

d) informon dhe merr masat e nevojshme për shmangien e rrethanave që mund të cenojnë integritetin e tij dhe procesin auditues në tërësi.

Neni 7

Pavarësia dhe objektiviteti

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjigjet vetëm përpara ligjit, në përputhje me detyrat funksionale që kryen. Ai duhet të zbatojë Kushtetutën, legjislacionin e brendshëm dhe standardet ndërkombëtare në fushën e auditimit, duke përmbushur detyrat e tij i lirë dhe i pavarur nga çdo ndikim i jashtëm apo grup interesi. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kryen detyrat duke marrë në konsideratë faktorët përkatës dhe i jep secilit prej tyre peshën e duhur në qëndrimin përfundimtar, duke përjashtuar çdo element që nuk i përgjigjet procesit konkret të punës. Sipas këtij parimi, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit:

a) respekton dhe punon për një institucion të pavarur kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin institucional;

b) tregon kujdes të vazhdueshëm që sjellja e tij, zyrtare apo private, të mos cenojë pavarësinë individuale apo institucionale të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

c) duhet të shmangë sjelljet që mund të krijojnë përshtypjen se është i angazhuar politikisht dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprimtari politike, në çfarëdo mënyre, me përjashtim të çështjeve me rëndësi për funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe

pavarësinë e këtij të fundit. Punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit kujdesen që, në çdo rast, të shfaqin paanshmëri politike në fakt dhe në dukje;

ç) nuk duhet t'u japë kontribute financiare apo kontribute të tjera subjekteve politike dhe as të nënshkruajë peticione që ndërmerren nga subjekte politike;

d) kujdeset që të bashkëpunojë me kolegët dhe respekton sistemin e brendshëm të varësisë dhe kontrollit;

dh) shmang çdo mënyrë përfshirjeje në vendimmarrjen e subjekteve të audituara. Nuk jep shërbime këshillimi apo shërbime të tjera përtej auditimit, kur këto shërbime cilësohen si përgjegjësi drejtimi për subjektet e audituara, ku përfshihen, por pa u kufizuar, drejtimi, vendimmarrja mbi burimet njerëzore, financiare, materiale e jomateriale;

e) nuk mund të auditojë punën e kryer nga ai vetë;

ë) nuk merr pjesë në auditimin e subjekteve, ku ka qenë së fundmi i punësuar, veçanërisht nëse ka qenë i përfshirë në procese vendimmarrëse, kur interesat personale apo marrëdhëniet me drejtuesit, stafin e subjektit të audituar ose subjektet e tjera mund të ndikojnë në vendimmarrje;

f) refuzon çdo dhuratë, shpërblim ose trajtim preferencial që mund të dëmtojë pavarësinë ose objektivitetin gjatë përmbushjes së detyrës;

g) refuzon pjesëmarrjen në një proces auditimi ku mund të vihet në diskutim pavarësia e tij, pavarësisht nëse shkak është i ditur apo jo nga të tretët;

gj) përmbush detyrat e tij në respekt të plotë të parimit të trajtimit të barabartë dhe të ekuilibruar të çështjeve apo subjekteve. Ai nuk duhet të favorizojë apo të diskriminojë një subjekt të caktuar për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjes politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, prirjeve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për ndonjë shkak tjetër të ngjashëm;

h) informon dhe merr masat e nevojshme për shmangien e rrethanave që mund të cenojnë procesin e punës në tërësi. Punonjësi informon drejtuesin në çdo rast edhe kur paraqiten rrethana të reja, të cilat në fakt apo edhe vetëm në dukje, do të shkaktonin që një palë e tretë të dyshonte në pavarësinë dhe objektivitetin e gjykimit të tij profesional apo të arrinte në përfundimin se është i ndikuar.

2. Në kuptim të këtij neni, përbëjnë interesa personale që cenojnë pavarësinë dhe objektivitetin:

a) marrëdhëniet e ngushta vetjake, familjare, miqësore, profesionale ose të interesit material a jomaterial, të cilat mund të shkaktojnë ndikim të padrejtë;

b) interesat e drejtpërdrejta financiare me subjektet e audituara;

c) përfshirja e punonjësit në bisedime për fillimin e marrëdhënieve të punës me subjektet e audituara;

ç) dhënia e opinioneve gjatë auditimit, rezultati i të cilëve mund të ketë ndikim financiar ose personal për atë punonjës;

d) përfshirja e punonjësit në një aktivitet joauditues me subjektet e audituara, që mund të ketë ndikim financiar ose personal për atë punonjës.

Neni 8

Njohuritë dhe aftësitë profesionale

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit i kryen detyrat e tij duke treguar nivelin më të lartë të aftësive profesionale. Ai duhet të tregojë me rezultatet e punës dhe komunikimin e

tij se zotëron njohuritë profesionale dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur detyrën në nivelin dhe standardin e kërkuar. Përmbushja e detyrave nga ana e punonjësit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ka përparësi ndaj të gjitha veprimtarive të tjera. Sipas këtij parimi, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit:

a) kryen punën e tij dhe përmbush detyrat e ngarkuara në përputhje me standardet e aplikueshme teknike, profesionale dhe etike si dhe duhet të jetë në gjendje të përshtatet me punën në kontekste e situata të ndryshme, të ndërlikuara apo të panjohura më parë, bazuar në gjykimin e shëndoshë profesional;

b) kryen detyrat e ngarkuara brenda një afati të arsyeshëm e të përshtatshëm dhe në varësi të ngarkesës, pa cenuar cilësinë e punës, por në çdo rast jo përtej afateve të përcaktuara në aktet e brendshme nënligjore;

c) kujdeset që angazhimi i tij në veprimtaritë e jashtme të mos cenojë kryerjen me cilësi të detyrave si punonjës i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

ç) synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë nivele të larta të aftësive profesionale;

d) ndërmer hapa të arsyeshëm për të ruajtur dhe rritur njohuritë, aftësitë dhe cilësitë personale, të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij;

dh) tregon kujdes të vazhdueshëm për zhvillimin e aftësive të tjera, në përshtatje të risive teknologjike që lidhen me punën e tij;

e) bashkëpunon dhe ndërvepron me eprorët, kolegët, vartësit dhe strukturat e brendshme institucionale për shkëmbimin e përvojës dhe njohurive profesionale;

ë) punonjësi me detyra drejtuese duhet të tregojë shkallë të lartë përgjegjësie si dhe aftësi organizative, drejtuese dhe komunikimi;

f) në marrëdhënie me institucionet e tjerë dhe organizatat e ndryshme, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit bashkëpunon me profesionalizëm, duke respektuar kompetencat dhe pavarësinë e çdo institucioni, bazuar në parimet e bashkëpunimit, mosdiskriminimit, besimit reciprok, zbatimit të kërkesave ligjore dhe duke shmangur vonesat e panevojshme.

2. Në rast se njohuritë e tij nuk janë të mjaftueshme për kryerjen e një detyre të caktuar, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit njofton eprorin ose drejtuesin përgjegjës për detyrën e caktuar.

Neni 9

Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit zyrtar

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit është përgjegjës dhe duhet të ruajë në mënyrë të përshtatshme informacionin që merr apo për të cilin vihet në dijeni gjatë kryerjes së detyrave të tij, në përputhje me detyrimin për transparencë dhe llogaridhënie. Sipas këtij parimi, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit:

a) nuk lejon dhënien apo përdorimin e paautorizuar të informacionit të marrë gjatë kryerjes së detyrës nga palët e treta, përveç rasteve kur ata kanë autoritetin e duhur dhe specifik, ose nëse ekziston një detyrim ligjor për dhënien apo përdorimin e një informacioni të tillë;

b) nuk duhet të përdorë informacionin që zotëron për shkak të detyrës për qëllime private, personale ose të të tretëve;

c) duhet të jetë vigjilent ndaj mundësisë së zbulimit të paqëllimshëm të informacionit konfidencial në favor të të tretëve;

ç) duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit zyrtar gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit;

d) duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit zyrtar kur diskuton çështje të lidhura me punën me kolegë, familjarë, të afërm apo në mjedise shoqërore të tjera, përfshirë rrjetet sociale;

dh) duhet të ruajë në forma e mënyra të sigurta, nëpërmjet fjalëkalimeve të përshtatshëm, programet dhe pajisjet e ndryshme kompjuterike që përdor për qëllime të kryerjes së detyrave të tij si punonjës i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

e) nuk mund të shpërndajë apo të publikojë dokumentacionin zyrtar që administrohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit pa autorizimin paraprak të eprorëve, me përjashtim të materialeve që publikohen në faqen zyrtare të institucionit në respektim të detyrimit ligjor për informimin e publikut.

2. Në rast se gjatë kryerjes së detyrave të tij, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit përballet me dokumente zyrtare, shkresore apo elektronike apo çdo informacion tjetër që përbën sekret shtetëror sipas përcaktimeve të legjislacionit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror, duhet të vërë menjëherë në dijeni eprorin e tij si dhe të tregojë kujdesin e duhur për të zbatuar detyrimet dhe rregullat që rrjedhin nga ky legjislacion.

3. Audituesi i Kontrollit të Lartë të Shtetit kryen auditim të veprimtarive që përbëjnë sekret shtetëror vetëm në rast se është i autorizuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe është i pajisur me certifikatën e sigurisë të lëshuar nga institucioni përkatës, sipas parashikimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të rregulloreve të brendshme.

Neni 10

Sjellja profesionale dhe etike

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij duhet të tregojë devotshmëri dhe të angazhohet maksimalisht për t'u shërbyer interesave të institucionit dhe publikut. Ai duhet të shmangë sjelljet e pahijshme, të cilat nuk respektojnë parimet profesionale dhe etike të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe çdo akt që nuk reflekton sjellje profesionale, edhe kur nuk ndalohet ligjërisht, në të gjitha veprimtaritë e tij, brenda dhe jashtë mjediseve dhe orareve të punës. Sipas këtij parimi, punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit:

a) në përputhje me llojin e detyrës që kryen, duhet të respektojë dinjitetin e detyrës, duke shmangur sjellje që cenojnë besimin publik në veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Për këtë qëllim, punonjësi sigurohet që sjellja e tij të jetë e rregullt dhe dinjitoze në perceptimin e një vëzhguesi mesatar;

b) nuk duhet të përfshihet në çështje apo situata që mund të cenojnë figurën e tij dhe imazhin e institucionit;

c) nuk lejon që zyra e tij të përdoret për qëllime të tjera nga ato që lidhen me kryerjen normale të detyrës në Kontrollin e Lartë të Shtetit;

ç) tregon kujdesin e duhur për të respektuar rregullat dhe procedurat lidhur me komunikimin e brendshëm zyrtar, me shkrim, me mjete elektronike apo verbal, sipas hierarkisë dhe llogaridhënies, në përputhje me aktet e brendshme nënligjore;

d) në marrëdhënie me eprorët, kolegët dhe vartësit, si dhe me subjektet e auditimit, duhet të ketë një komunikim etik, të sjellshëm dhe të respektueshëm. Komunikimi verbal dhe joverbal duhet të jetë korrekt, pa përdorur fjalor fyes apo paragjykes, për çfarëdolloj arsyeje apo shkak. Në mjediset e punës, përfshi vendet e punës ku zhvillohet procesi auditues, nuk mund të komunikohet me zë të lartë apo të përdoren shprehje të papërshtatshme;

dh) duhet të shmangë ngacmimet fizike ose verbale apo ato sjellje të cilat, edhe pse nuk përbëjnë ngacmime ose abuzime, mund të krijojnë një mjedis armiqësor ose kërcënues;

e) përdor në mënyrë efektive kohën e punës, duke ia kushtuar atë vetëm veprimtarive zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

ë) respekton hyrje-daljet në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit sipas orarit zyrtar të përcaktuar, me përjashtim të rasteve kur, për arsye objektive, autorizohet ndryshe nga eprori ose titullari;

f) nuk duhet të frekuentojë brenda orarit zyrtar ambiente të ndryshme nga ai i punës, me përjashtim të rasteve të lidhura me kryerjen e detyrave funksionale;

g) duhet të kujdeset për paraqitjen e jashtme dhe higjienën personale. Paraqitja në punë dhe veshja duhet të jetë e denjë dhe zyrtare, në përshtatje me detyrën që kryen, në mënyrë që veshja të përmbushë standardet e profesionalizmit dhe modestisë, duke shmangur krijimin e përshtypjes së pahijshme dhe dëmtrimin e imazhit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Paraqitja në punë duhet të jetë me:

i) veshje të pastra e të rregullta, të përshtatshme dhe të pranueshme;

ii) veshja për punonjësit meshkuj duhet të jetë me pantallona, këmishë dhe kravatë, duke përdorur modele zyrtare;

iii) veshja për punonjëset femra duhet të jetë me funde apo pantallona serioze, apo fustane me gjatësi të pranueshme, këmisha dhe bluza pa dekolte, me këpucë ose sandale të përshtatshme;

iv) veshjet jozyrtare, në çdo rast të pranueshme, lejohen vetëm ditëve të premte, por në takime pune jashtë institucionit punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të paraqitet me veshje zyrtare;

v) veshjet apo këpucët, në përgjithësi, duhet të kenë mundësisht ngjyra jo me shumë kontraste, pa stampime të mëdha të motiveve, shënimeve apo simboleve ekstravagante;

vi) aksesoret e veshjeve duhet të jenë me ngjyra dhe simbole të thjeshta, që i përshtaten natyrës zyrtare;

vii) flokët, gjatë punës, duhet të mbahen në mënyrë të rregullt. Punonjësit meshkuj që mbajnë mjekër ose mustaqe duhet të sigurohen që të jenë të rregullt;

gj) në marrëdhëniet me publikun, trajton me mirësjellje të gjithë qytetarët, duke treguar përkushtim, mirësjellje dhe ndihmesë profesionale;

h) shfaq vetëpërmbajtje në marrëdhëniet me median duke shmangur dhënien në publik apo në media të deklaratave ose mendimeve që mund të interpretohen si të lidhura me detyrën që kryen në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe që mund të cenojnë institucionin. Punonjësi duhet të shmangë komunikimin e paautorizuar me median dhe çdo shfrytëzim të njohjeve personale me gazetarët. Për çështje që lidhen me marrëdhëniet me median, autorizimi jepet në çdo rast nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ose nga personat e autorizuar prej tij;

i) shmang realizimin dhe publikimin në çfarëdolloj forme të fotove, videove, regjistrimeve të tjera, të vetvetes, kolegëve, ambienteve të punës, proceseve të punës, subjekteve të auditimit, në media apo rrjete sociale, për qëllime që nuk lidhen me punën apo me aktivitete zyrtare. Punonjësi duhet të jetë i kujdesshëm që me veprimet ose opinionet e tij në media apo rrjete sociale, të mos dëmtojë ose diskreditojë imazhin e institucionit. Punonjësi nuk duhet të japë opinion duke bërë me dije se mban një detyrë apo funksion zyrtar, pasi mund të cenojë besimin publik për paanshmërinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit, qoftë edhe gjatë pjesëmarrjes në forume ose blogje që pretendohet të jenë anonime;

j) nuk përdor telefonin celular privat gjatë takimeve dhe mbledhjeve të punës;

k) nuk konsumon pije alkoolike gjatë orarit të punës;

l) shmang frekuentimin e ambienteve, lokaleve apo vendeve të padenja, të cilat mund të dëmtojnë ose të hedhin dyshime mbi figurën e tij morale dhe që cenojnë imazhin e institucionit apo kryerjen e veprimeve të ekzagjeruara në bare, lokale, restorante, parqe apo ambiente të tjera publike që sjellin të njëjtat pasoja;

ll) shmang shoqërimin me persona privatë, që mund të kenë interesa të lidhura me veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit apo shoqërimin e qëllimshëm me persona të përfshirë në veprimtari të paligjshme;

m) duhet të ruajë dhe mbrojë pronën, mjetet e punës, pajisjet dhe mallrat në administrim të institucionit, si dhe dokumentacionin zyrtar, si dhe të marrë masat për përdorimin e tyre vetëm për qëllime të përmbushjes së detyrave funksionale. Në rast të keqfunksionimit të mjeteve të tij të punës, duhet të njoftojë menjëherë eprorin direkt dhe njësinë e shërbimeve mbështetëse.

2. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të informojë eprorët për çdo konflikt apo situatë që mund të cenojë apo rrezikojë kërkesat për një sjellje profesionale dhe etike.

3. Për qëllime të këtij Kodi, përbën ngacmim çdo fjalë apo sjellje që ndërhyt në mënyrë të paarsyeshme në privatësinë e tjetrit apo që krijon një mjedis pune kërcënues, armiqësor dhe fyes. Përbën ngacmim seksual, çdo sjellje e padëshiruar seksuale, kërkesat për favore seksuale ose sjellje të tjera fizike apo verbale me natyrë seksuale, të cilat ndërhyjnë, kushtëzojnë ose krijojnë një mjedis pune fyes, armiqësor apo kërcënues.

Neni 11

Konflikti i interesit

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të lejojë që interesat private të bien ndesh me detyrën e tij, duhet të shmangë konfliktin e interesave, të mos shfrytëzojë pozitën publike për interesin privat, të mos kryejë veprime arbitrare dhe duhet të respektojë të drejtat dhe interesat personale të të tretëve. Në çdo rast, punonjësi duhet të veprojë në interes të institucionit dhe veprimtaria e tij duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e fushës, aktet nënligjore, rolin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave.

2. Punonjësi që kryen funksione audituese nuk lejon që paragjykimet, konflikti i interesit ose persona të tretë, të ndikojnë në mënyrën se si ai mbledh, vlerëson dhe përcjell informacionin mbi veprimtarinë e subjektit që auditohet.

3. Punonjësi që kryen funksione audituese nuk duhet të përdorë pozitën e tij zyrtare për qëllime private dhe duhet të shmangë marrëdhëniet dhe kontaktet sociale të qëllimshme me subjektin që auditohet, të cilat mund të ndikojnë, kompromentojnë ose vënë në rrezik aftësitë e tij për të vepruar në mënyrë të pavarur.

4. Punonjësi që kryen funksione audituese shmang çdo formë presioni apo ndikimi të faktorëve të jashtëm, duke mos u përfshirë në situata të tilla si:

a) interesat financiare në fushën objekt auditimi si dhe marrëdhëniet e ngushta me personat që kanë interesa të tilla;

b) këndvështrime ose përfitime personale, të cilët ndikojnë paanësinë në dhënien e rekomandimeve;

c) marrëdhëniet personale me punonjësit e subjektit që auditohet, në një masë të tillë që tejkalojnë marrëdhëniet profesionale;

ç) aktivitetet politike ose shprehja e qëndrimeve politike në lidhje me subjektin e audituar ose me veprimtarinë e tij;

d) punësimet e mëparshme të audituesit, si person përgjegjës për një aktivitet që auditohet ose si staf i subjektit që auditohet. Nëse audituesi ka qenë i punësuar në një subjekt të caktuar, nuk lejohet pjesëmarrja e tij në grupin e auditimit të këtij subjekti, deri në dy vjet pas largimit nga ky i fundit;

dh) të afërm ose miq të ngushtë të audituesit, të cilët janë të punësuar në subjektin që auditohet.

5. Përpara fillimit të çdo auditimi, audituesi plotëson deklaratën e konfliktit të interesave, sipas parashikimeve të Rregullores së Procedurave të Auditimit. Audituesi duhet të raportojë pranë eprorit direkt ose drejtuesit përgjegjës të auditimit ku është pjesë, menjëherë pas vënies në dijeni, për ndonjë konflikt real ose të mundshëm të interesit që mund të shfaqet gjatë kryerjes së auditimit. Mosdeklarimi i konfliktit të interesit ngarkon me përgjegjësi audituesin.

6. Kur ekzistenca e konfliktit të interesit nuk është e qartë, drejtuesi i grupit të auditimit ose vetë audituesi i drejtohet Strukturës së Etikës, e cila bën verifikimin e situatës që mund të përbëjë konflikt interesi. Struktura përpilon raportin për cilësimin e rrethanave përkatëse dhe e paraqet më pas te Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas parashikimeve të bëra në aktet nënligjore të institucionit. Çdo rast i identifikuar apo i raportuar sipas kësaj procedure, pasqyrohet në dokumentacionin përkatës dhe administrohet në dosjen e auditimit.

7. Konfliktet e mundshme të interesit të një kandidati për t'u punësuar në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të zgjidhen përpara emërimit të tij dhe në rast gabimi të mëparshëm, duhet të korrigjohen me dëshirën dhe vullnetin e mirë të punonjësit dhe drejtuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KREU III

RREGULLAT MBI VEPRIMTARITË E JASHTME DHE INTERESAT PRIVATE

Neni 12

Ushtrimi i veprimtarive të jashtme

1. Angazhimi në veprimtari të jashtme i punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit rregullohet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe të Rregullores së Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, nëse:

- a) ajo krijon ose duket sikur krijon një konflikt interesash me pozicionin e tij zyrtar;
- b) angazhimi mendor dhe fizik i punonjësit në këtë veprimtari ndikon, pengon ose e vështirëson kryerjen e detyrave të tij funksionale;
- c) veprimtaria e jashtme cenon figurën e tij ose të institucionit;
- ç) veprimtaria e jashtme është vazhdim i detyrave të tij zyrtare dhe punonjësi duhet të përdorë të dhënat që siguron nga pozicioni i tij;
- d) qëllimi i veprimtarisë bie në kundërshtim me qëllimin dhe objektivat e pozicionit zyrtar të punës;
- dh) është një veprimtari, që kryhet me kohë të plotë.

3. Në rast dyshimi për cilësimin e një veprimtarie si të lejueshme ose jo, punonjësi këshillohet me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Strukturën e Etikës.

Neni 13

Dhuratat, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale

1. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet të kërkojë ose të pranojë në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, familjen, të afërmit, personat fizikë apo juridikë me të cilët ka marrëdhënie:

a) dhurata, favore, trajtime preferenciale, pritje apo çdo përfitim tjetër, si dhe premtime për to, të cilat i jepen për shkak të detyrës së tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës;

b) fitesa për pritje të ndryshme, premtime, ofrime falas apo ulje të çmimeve për kryerjen e shërbimeve, të argëtimeve, pushimeve, transporteve, udhëtimeve;

c) përfitime të bursave të studimit apo të sigurimeve.

2. Punonjësi që ka cilësinë e eprorit, duhet të ushtrojë kujdesin e duhur që anëtarët e grupit të auditimit që drejton, të mos pranojnë asnjë nga përfitimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, të cilët mund të ndikojnë në gjykimin e tyre profesional ose që mund të perceptohen sikur ndikojnë në pavarësinë ose integritetin e secilit anëtar.

3. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk merr përsipër dhe as bën premtime, lidhur me kryerjen ose moskryerjen e veprimeve gjatë ushtrimit të detyrës së tij ose të kolegëve, që mund të përbëjnë shkak për njëanshmëri gjatë ushtrimit të detyrave.

4. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, t'i japë, të kërkojë ose të ndërmjetësojë për t'i dhënë dhurata një punonjësi të një niveli më të lartë apo të afërmve të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga punonjësi i një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe marrëdhënieve zyrtare.

5. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të pranojë dhurata nga autoritetet e huaja apo organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, mirësjelljes apo protokollit, nëse nuk tejkalohen kufijtë e traditës dhe të zakoneve të vendit ku jepen, nuk vihet në dyshim objektiviteti, ndershmëria dhe paanshmëria e punonjësit si dhe nëse nuk preket a vihet në rrezik imazhi dhe integriteti i institucionit.

6. Në asnjë rast, punonjësi nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

7. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të mbajë dhurata të lejueshme, pa qenë i detyruar t'i deklarojë ato, nëse nuk e kalojnë vlerën prej 10 000 (dhjetëmijë) lekë për dhuratë. Nëse punonjësi ka dyshim për vlerën e dhuratës, njofton eprorin direkt dhe i kërkon strukturës së financës të kryejë vlerësimin e saj.

8. Dhuratat e pranuar nga punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit nga delegacione të çfarëdo natyre apo individë, mbi vlerën e caktuar, për shkak të pozicionit të tij, duhet të deklarohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve tek eprorët, si dhe në strukturën e financës.

9. Struktura e financës bën vlerësimin e dhuratave dhe inventarizon ato me vlerë më të madhe se 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Dhuratat e inventarizuara regjistrohen si aktive të institucionit nëpërmjet fletë-hyrjeve përkatëse dhe administrohen në një vend të posaçëm për t'u përdorur për qëllime të veprimtarisë institucionale.

10. Dhuratat që kanë vlera artistike, muzeore apo historike, i dorëzohen muzeut të institucionit.

11. Në rast se punonjësi dëshiron të mbajë dhuratën me vlerë mbi 10 000 (dhjetë mijë) lekë, pas vlerësimit të bërë nga struktura e financës, paguan diferencën e vlerës.

12. Diferenca e dhuratave që kalojnë vlerën 10 000 lekë paguhet në llogarinë e të ardhurave të degës së thesarit, në një nga bankat e nivelit të dytë, sipas mandat arkëtimit të lëshuar nga struktura e financës së Kontrollit të Lartë të Shtetit.

13. Për qëllime të këtij neni, dhurata konsiderohet e marrë në mënyrë të tërthortë kur i jepet familjes së punonjësit, të afërmve të tij deri në shkallë të dytë, personave ose organizatave me të cilat punonjësi ka pasur ose ka marrëdhënie interesi, në bazë të kërkesës, rekomandimit apo udhëzimit të punonjësit.

KREU IV STRUKTURA E ETIKËS

Neni 14

Funksioni i strukturës së etikës

1. Struktura e Etikës në Kontrollin e Lartë të Shtetit është përgjegjëse dhe mbikëqyr zbatimin në përditshmëri të Kodit të Etikës nga punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në bashkëpunim me eprorët direkt dhe me drejtuesit e departamenteve ose të drejtorive.

2. Këto struktura, në bashkëpunim mes tyre, trajtojnë, verifikojnë, këshillojnë dhe u japin zgjidhje çështjeve, paqartësive dhe ankesave që paraqiten nga çdo punonjës i Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave të këtij Kodi.

3. Struktura e Etikës bashkëpunon me eprorin dhe punonjësit për trajtimin e ankesës së punonjësit, ndaj të cilit janë ngritur pretendime të pabazuara prej çdokujt që ka mbetur i pakënaqur nga kryerja e rregullt e detyrës prej tij.

4. Struktura e Etikës ka të drejtë t'i propozojë Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ndryshime në Kodin e Etikës.

5. Ngritja, përbërja dhe detyrat e Strukturës së Etikës përcaktohen në Rregulloren e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 15

Këshillimi dhe interpretimi

1. Struktura e Etikës është përgjegjëse për këshillimin dhe informimin e çdo punonjësi të Kontrollit të Lartë të Shtetit, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për standardet e sjelljes dhe etikës:

a) në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës, përmes njohjes me legjislacionin përkatës në fuqi;

b) gjatë ushtrimit të detyrës, përmes formimit profesional dhe trajnimeve të planifikuara;

c) në çdo rast tjetër, me kërkesë të punonjësit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka të drejtë të kërkojë nga Struktura e Etikës një opinion këshillimor për çështje të diskutueshme të etikës, lidhur me sjellje apo veprime të caktuara gjatë ushtrimit të detyrës apo jashtë saj, nëse ato konsiderohen ose jo në pajtim me standardet e këtij Kodi.

3. Këshillimi apo interpretimi mund të kërkohet dhe nga eprori, për sjellje, veprime apo mosveprime të punonjësit që ka në varësi, nëse mendon se vijnë në kundërshtim me këtë Kod.

4. Interpretimi i Kodit të Etikës, i bërë nga Struktura e Etikës, me kërkesën e një prej subjekteve të fushëveprimit të këtij Kodi, lidhur me faktin nëse norma përkatëse e lejon një sjellje apo qëndrim të caktuar, mund të përdoret si mjet mbrojtjeje nga ana e tij në rast procedimi disiplinor, por ky interpretim nuk ka karakter detyrues për zgjidhjen ose vlerësimin e rasteve të tjera të ngjashme.

Neni 16 Informimi

1. Struktura e Etikës informon punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit periodikisht:
 - a) nëpërmjet *email*-eve informuese, për raste dhe situata që përfshijnë zbatimin e rregullave të etikës dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
 - b) nëpërmjet mbajtjes së aktiviteteve të shkurtra, me qëllim përditësimin e njohurive të punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për situata dhe raste që lidhen me rregullat e etikës dhe sjelljes;
 - c) mbi bazën e rasteve konkrete, nga praktika në Republikën e Shqipërisë ose e vendeve të tjera, përfshirë dhe organizatat ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit.
2. Gjatë procesit të informimit periodik, rastet apo situatat jepen në mënyrë të anonimizuar, duke shmangur identifikimin e punonjësve si dhe të institucioneve të përfshira në proces.

Neni 17 Zgjidhja e problemeve dhe e konflikteve personale

1. Struktura e Etikës, në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve ose drejtorive, trajton me efikasitet dhe në kohën më të shkurtër çdo kërkesë ose shqetësim të paraqitur nga punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke ruajtur konfidencialitetin si dhe duke treguar ndjeshmëri, paanshmëri, objektivitet dhe mosdiskriminim.
2. Struktura e Etikës, në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve ose drejtorive, krijon mjedisin e përshtatshëm në mënyrë që punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit të ndihen të lirë për të përdorur mjetet institucionale ekzistuese për zgjidhjen e problemeve apo të konflikteve të çdo lloji, si dhe të shprehin çdo shqetësim që kanë për situatat problematike apo konfliktuale ku ndodhen ose ku mund të ndodhen, brenda ose jashtë institucionit.
3. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të vlerësojë dhe verifikojë me kujdesin e duhur faktet dhe informacionet përpara raportimit të një paqartësie etike, situatë apo konflikti, që trajtohen nga ky Kod.
4. Punonjësi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, tregon kujdesin e duhur për të shmangur mosmarrëveshjet me kolegët dhe nëse ato ndodhin, duhet të bëjë përpjekje për t'i zgjidhur me pajtim. Kur mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në këtë mënyrë dhe ndikon në mbarëvajtjen e punës, punonjësi vë në dijeni eprorin direkt për situatën.

Neni 18 Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Shkelja ose moszbatimi i rregullave të përcaktuara në këtë Kod përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
2. Struktura e Etikës, pasi del në përfundimin se është kryer një shkelje e Kodit të Etikës, vë në dijeni Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nëpërmjet një akti me shkrim.
3. Në rast konstatimi të një shkeljeje të Kodit të Etikës nga punonjësi që kryen funksione audituese, kryesisht ose nëpërmjet njoftimit nga strukturat përgjegjëse, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit vendos nëse punonjësi do të vijojë të jetë pjesë e grupit të auditimit. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe nga eprori direkt, vendimi i të cilit miratohet nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Shkelja e këtij Kodi, kur nuk përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit të punës së punonjësit që ka statusin e nëpunësit civil.

5. Procedura disiplinore në kuadër të shkeljes së rregullave të Kodit të Etikës, rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Rishikimi dhe ndryshimet e Kodit të Etikës

1. Kodi i Etikës i nënshtrohet rishikimit të vazhdueshëm dhe mund të ndryshohet në çdo kohë sipas dispozitave përkatëse të ndryshuara të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, akteve nënligjore të mbështetur në këtë ligj dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e auditimit të jashtëm.

2. Çdo ndryshim i bërë në këtë Kod, nuk ka fuqi prapavepruese.

Neni 20

Hyrja në fuqi

1. Kodi i Etikës hyn në fuqi pas miratimit me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Kodi i Etikës publikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe, bashkë me vendimin e miratimit, u dërgohet për dijeni individuale të gjithë punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.